

# Korniza për Planet Komunale të Arsimit



## KOMUNA E VUSHTRRIË PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT 2017- 2020



Prill, 2017

## **HYRJE**

Prezantimi i përgjithshëm i Komunës:

Vushtrria shtrihet në pjesën veriore të Kosovës dhe i takon regjionit të Mitrovicës . Sipërfaqja e saj është 345 km<sup>2</sup>, më 66 fshatra, bashkë më qytetin 67 vendbanime. Sipas regjistrimit të vitit 2011 banorë resident të Vushtrrisë janë rreth 70.000 banorë. Komuna e Vushtrrisë është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës e cila ofron shërbime komunale më 12 Drejtori. Kuvendi i Komunës ka 35 deputet. Organet komunale janë; Kuvendi i Komunës dhe kryetari. Kuvendi i komunës dhe kryetari miratojnë akte dhe ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre. Të gjitha aktet komunale janë në përputhje me sistemin kushtetutes dhe ligjor të Republikës së Kosovës. Sipas statutit të Komunës, kryetari ofron debat më qytetarë dy herë në vit. Komuna e Vushtrrisë njihet transpatente në të gjitha shërbimet dhe projektet për qytatarë, ku edhe zbaton Planin e veprimt për transparencë. Ofron UEB faqen ku në të do të gjeni informacione në kohë për të gjitha zhvillimet komunale.

## **Hyrje e përgjithshme në sistemin arsimor të Kosovës dhe nga objektivat kryesore të të Planit Strategjik i Arsimit të Kosovës:**

Arsimimi parauniversitar dhe parashkollor organizohet përmes një kornize të mësimit tërë jetësor sipas niveleve të ISCED-it si vijon dhe në pajtim me fazat kryesore të Kornizës Kombëtare të Kurrikulumit: 1.1. niveli 0: Arsimi parashkollor 1.2. niveli 1: Arsimi fillor; 1.3. niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët; 1.4. niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë që zgjat 1.5. niveli 4: Arsimimi postsekondar në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional 1.6. programe të mësimit gjatë gjithë jetës për të rritur që mund të ofrohen në nivelet 3, dhe 4 të ISCED-it.

**OBJEKTIVAT KRYESORE TË PLANIT STRATEGJIK TË ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021:**

### **Objektivi Strategjik/OS 1: Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja**

Rritja e përfshirjes dhe mundësitë e barabarta për zhvillim, aftësim dhe arsimim të çdo individi në arsimin parauniversitar.

### **Objektivi Strategjik/OS 2: Menaxhimi i sistemit arsimor**

Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

### **Objektivi Strategjik/OS 3: Sigurimi i Cilësisë (SC)**

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

### **Objektivi Strategjik/ OS 4: Zhvillimi i mësimdhënësve**

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve

### **Objektivi Strategjik/ OS 5: Mësimdhënia dhe të nxënit**

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë.

### **Objektivi Strategjik/ OS 6: Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) dhe Arsimit për të Rritur (ARr)**

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe krijimi i një sistemi të hapur të arsimit për të rriturit.

### **Objektivi Strategjik/ OS 7: Arsimi i Lartë (AL)**

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.


### **Arsyeja e planit dhe për kë është plani:**

Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit është dedikuar arsimit të Komunës së Vushtrrisë në përgjithësi , e në veçanti Drejtorisë Komunale të arsimit në Vushtri . Nëpërmjet planit zhvillimor të realizojmë objektivat zhvillimore të arsimit të Komunës sonë. Në fokus kryesor ka bashkëpunim më të gjithë akteret që janë të kyçur në sistemin arsimor, si drejtorët e shkollave , mësimdhënësit, nxënësit prindërit dhe komunitetin. Duke e konsideruar Planin Zhvillimor të arsimit Komunal si dokument për rregullimin dhe zhvillim dhe mundësi ofruese për siguri të cilësisë. Ky dokumnet obligon mbikqyrje të pandërperë më qëllim të përparimit bashkëkohor karshi trendeve evropiane.

Çka ofroni për fëmijët e komunës; Statistikat:

Niveli parashkollor, parafillor	PO
Niveli fillor	PO
I mesëm	PO
I lartë	PO
Sa fëmijë	14626
Sa shkolla	36
Sa mësimdhënës	897

## Harta e komunës:



Ofrimi i shërbimeve të arsimit shprehur në Euro dhe në % të buxhetit komunal, dhe prej nga vijnë mjetet financiare: granti i arsimit, tatimi në pronë (p.sh. të hyrat vetanake), participimi, MASHT-i, donatorët. Shpenzimet për fëmijë në Euro.

Ofrimi i shërbimeve të arsimit 223580 € i shprehur në 14.31%  
Granti i arsimit 81669 €  
Të hyrat vetanake 48900€  
Granti i përgjithshëm 174680 €  
Shpenzimet për fëmijë 15.1 për nxënës

Informata rreth Drejtorisë Komunale të Arsimit:

Drejtoria e Arsimit në Vushtrri të gjitha detyrat e punës së vetë organizative i mbështet në kuadër të kopmetencave, ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve komunale, planeve të secilit zyrtar, PZHAK-së, dhe sipas PZSHH-së. Për të gjitha nivelet ofron dhe menaxhon institucionet edukativo – arsimore publike parauniversitare. DKA- në Vushtrri ka 10 punojnës bashkë me drejtorin 11-të secili zyrtar mban pozitat: Zyrtari i arsimit parafillor dhe fillor, Zyrtari i arsimit të mesëm të ultë, Zyrtari i arsimit të mesëm të lartë, Zyrtari ligjor, Zyrtari për buxhet, Zyrtari për zotime, Zyrtari i depos, Përgjegjësi teknik për shkolla, Asistentja administrative, Koordinator i qendres së trajnimeve, Në funksion të këtij zhvillimi funksionojnë edhe ekipet që i ndihmojnë shkollave si :

Ekipi për paraandalim, reagim ndaj braktisje dhe mosregjistrim.

Ekipi për vlerësim të fëmijëve më nevoja të veçanta.

Koordinatori i kurrikulës në nivel komunal.

Koordinatori i cilësisë në nivel komunal.

Ekipi në task forcën e menaxhimit të rasteve si dhe ekipi për rinetgurm të personave të riatdhesuar.

## **Mesazhet e falenderimeve:**

Ky draft plan zhvillimor i Arsimit është përgatitur me iniciativën e drejtorit të Arsimit të Vushtrisë z. Musaj Tërbunja Ndërsa është punuar nga zyrtarët e DKA-së;

Enver Bajrami

Kadrije Meniqi

Agim Miftari

Xhevrije Halili

Hashim Hajrizi

Bajram Ibrahim

Sugjerimet shitesë kemi marrë nga;

Selim Mehmeti-hulumtues për standarde dhe vlerësim , punonjës në Insitutin Pedagogjik të Kosovës

Komiteti për Politikë dhe Financa

Deputet e Kuvendit Komunal

Bajram Beqiri –Kryetar i këshillit të prindërve në nivel Republike

DKA-Vushtrri i falenderon pjesëmarrësit dhe kontributdhënësit në përpilimin e këtij drafti .

## **Disa nga listat e shkurtesave të përdorura**

DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
KKK	Korniza e Kurrikulit të Kosovës
QNP	Qendra për ngritje profesionale
UA	Udhëzim Administrativ
PIA	Plani Individual për Arsim
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
PZHKA	Plani zhvillimor komunal i Arsimit
PZHSH	Plani zhvillimor i shkollave
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
ERPMB	Ekipe për reagim ndaj mos regjistrimit dhe parandalim të braktisjes
KDSH	Këshilli drejtues i shkollës



## **DEKLARATA E VIZIONIT**

Sistemi arsimor para universitar të shërbej në funksion të realizimit të kompetencave themelore, që përmes tyre të zhvillojnë dije , shkathhtësi qëndrime dhe vlera përballë shoqërisë demokratike. Për të ju mundësuar arsim të barabartë në fokus sigurimin e cilësisë në arsim si dhe përmirësimin e kushteve optimale për zhvillim të qëndrueshëm të edukimit dhe arsimimit.

## **DEKLARATA E MISIONIT**

Drejtoria e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, ka mision ta zhvillojë arsimin në të gjitha nivelet që janë në përgjegjësi të komunës, duke krijuar kushte të përshtatshme për mësimdhënie dhe nxënie, gjithë përfshirje në arsim, zhvillim të kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të përcaktuara nga shoqëria, autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle dhe përmes zhvillimit të mekanizmave që rrisin përgjegjësinë dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e arsimit në komunë.

## KONTEKSITI I PLANIFIKIMIT ZHVILLIMOR

**Objektivi kombëtar është që të rritet gjithë përfshirja dhe shmangia e braktisjes së shkollimit në arsimin para universitar. Në komunën tonë çështjet kyçe janë:**

Në Komunën e Vushtrisë në nivelin para fillor kemi rritur në mënyrë progresive vende në nivelin para fillor ashtu që të shprehur në përqindje 68.36% janë përfshirë në nivelin para fillor publik , ndërsa publiko privat 31,63%. Ndërsa planifikohet partneritet me sektorin privat . Ekipi për ERPMB koordinon punën e vetë me gjithë partneret tjerë si: Qendra për punë dhe mirëqenie sociale, Policia e komunitetit, Qendra e shëndetësisë familjare, shërbimet profesionale si pedagogu , psikologu etj.

Objektivi kombëtar është që të zhvillohet një sistem cilësor dhe efektiv i menaxhimit të arsimit në bazë të transparencës dhe llogaridhënies. Në komunën tonë çështjet kyçe janë:

Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë; SIA. DKA, Shkolla

Objektivi kombëtar është rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes një sistemi të qëndrueshëm të përgatitjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në Komunën tonë çështjet kyçe janë:

Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune:

Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor

Monitorimi dhe mbështetja e zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave

Objektivi kombëtar është rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes një sistemi të qëndrueshëm të përgatitjes dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Në komunën tonë çështjet kyçe janë:

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit efektiv dhe të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Objektivi kombëtar është për të çuar përpara të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën me bazë në kompetenca dhe duke përdorur burimet e cilësisë së lartë të mësimdhënies të . Në komunën tonë çështjet kyçe janë:

Realizimi i procesit mësimor në funksion të mësimi të integruar dhe zhvillimit të kompetencave kryesore

**Plani Zhvillimor i Arsimit në Komunë është i lidhur me planet e tjera të përgatitura nga komuna dhe komuniteti arsimor, këto janë:**

**Planet Zhvillimore të Shkollave**

Çështjet kryesore nga planet zhvillimore të shkollave janë se analize e plotë e planeve të shkollave është e paraqitur në një faqe të ndarë.	Të planet zhvillimore te shkollave
--	------------------------------------

**Plani Zhvillimor Komunal**

Plani afatgjatë zhvillimor komunal parasheh këto zhvillime në sektorin e arsimit	Zhvillimi i sigurimit të cilësisë Zbatimin e KKK Ambient të përshtatshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies
--	---

**Korniza Afat-Mesme e Shpenzimeve (KASH)**

KASH-i shikon përpara për burimet në dispozicion për sektorin e arsimit dhe në vitin 2017 buxheti ynë bazë i planifikuar është €	702,841.00
--	------------

**Plani:**

Investimet kapitale:702,841.00€
---------------------------------

**Plani:**

Investimet kapitale në formë analitike:89,000.00€
---

**Plani:**

Subvencionet:33,000.00€
-------------------------

## Përmbledhja grafike e planit zhvillimor komunal

**Vizioni :** Sistemi arsimor para universitar të shërbej në funksion të realizimit të kompetencave themelore, që përmes tyre të zhvillojnë dije , shkathtësi qëndrime dhe vlera përballë shoqërisë demokratike. Për të ju mundësuar arsim të barabartë në fokus sigurimin e cilësisë në arsim si dhe përmirësimin e kushteve optimale për zhvillim të qëndrueshëm të edukimit dhe arsimimit

**Misioni:** Drejtoria e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, ka mision ta zhvillojë arsimin në të gjitha nivelet që janë në përgjegjësi të Komunës, duke krijuar kushte të përshtatshme për mësimdhënie dhe nxënie, gjithëpërfshirje në arsim, zhvillim të kompetencave të nxënësve sipas kërkesave të përcaktuara nga shoqëria, autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle dhe përmes zhvillimit të mekanizmave që rrisin përgjegjësinë dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e arsimit në komunë.

<p>Prioriteti 1. Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë</p> <p>Rezultati:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Koordinator i cilësisë dhe ekipi i V BSH-së</li> <li>- Sistemi efikas për vlerësim të shkollës</li> <li>- Vlerësimi i performancës së shkollës</li> <li>- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve</li> <li>- Përfornaca e matshme e nx.</li> </ul>	<p>Prioriteti 2. Ndërlidhja e programeve shkollore me nevojat e tregut të punës</p> <p>Rezultati:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritja e bashkëpunimit, shkollë profesionale me tregun e punës</li> <li>- Realizimi i praktikës profesionale në ndërmarrje</li> <li>- Rritja e numrit të nxënësve që punësohen</li> </ul>	<p>Prioriteti 3. Githëpërfshirja në arsim</p> <p>Rezultati:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshirja e shtuar e fëmijëve në edukimin parashkollor</li> <li>- Përfshirja e gjithë nxënësve në arsimin e obliguar më mundësi të barabarta</li> <li>- Fëmijët më nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar</li> <li>- Integrimi i nx. të komunitetit pakicë</li> <li>- Integrimi i nxënësve, të riatdhesuar.</li> </ul>	<p>Prioriteti 4. Ambiente të përshtatshme shkollore</p> <p>Rezultati:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Infrastruktura shkollore bashkëkohore</li> <li>- Teknologjia bashkëkohore</li> <li>- Kabinetet shkencore në funksion të mësimi praktik.</li> </ul>	<p>Prioriteti 5 Menaxhimi i sistemit arsimor</p> <p>Rezultati:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtohen kapacitete për menaxhimin efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin komunal</li> <li>- Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimit dhe menaxhimit të karrierës së udhëheqësve të institucioneve ed-arsimore</li> <li>- Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në SMIA.</li> </ul>
--	--	--	---	--

### PRIORITETET, REZULTATET DHE MASAT: DETAJET

#### Prioriteti 1: Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Koordinatori i cilësisë dhe e ekipi i VBSH.	1.1. Koordinatori i cilësisë në nivel komunal monitoron , përkrah koordinatorin e cilësisë në nivel komunal.	1.1.Vendimet e emëruara për koordinator të cilësisë si dhe për anëtarët e ekipit. 1.2. Dëshmia e raporteve të koordinatorëve të cilësisë në nivel shkolle.
Rezultati 2: Sistemi efikas për vlerësim të shkollës.	2.1.Trajnimi i koordinatorëve të cilësisë. 2.2.Trajnimi i drejtorëve të shkollave . 2.3Sesionet informuese për ekipin e VBSH –së. 2.4 Përkrahja nga Koordinatori i Cilësisë në nivel komunal .	2.1,2,3,4.Në bazë të protokollit të vëzhgimit.
Rezultati 3: Vlerësimi i performancës së shkollës.	3.1.Ekipi i VBSH-së , në të gjitha shkollat ku janë të trajnuara 3.2. Ekipet e VBSH-së, vlerësojnë të paktën një fushë të cilësisë në fazën fillestare , pastaj vlerësimi behet duke u bazuar në udhëzime administrative.	3.1,2.Monitorimi i vazhdueshëm i dosjeve të vlerësimit të shkollës .
Rezultati 4: Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve.	4.1. Ndërtimi i mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm profesional. 4.2. Ofrimi i Qendrës trajnuese për zhvillim profesional. 4.3. Planifikimi i mjeteve buxhetore nga shkollat për trajnime. 4.4. Trajnimi i mësimitdhënësve për KKK-së në fazat e para të zbatimit.	4.1.Certifikimi. 4.2. Dosja. 4.2. Monitorimi. 4.3. Vlerësimi VBSH. 4.4. Zbatimi i KK në klasën 0, I, VI, X.
Rezultati 5: Përformanca e matshme e nxënësve.	5.1. Organizimi i programeve shtesë nga shkollat për përgatitjen e nxënësve për vlerësimet e jashtme.	5.1,2,3,4.Raporti nga vlerësimi i jashtëm. 5.5,6.Rezultatet nga rangimi, certifikimi dhe kualifikimi

**Prioriteti 2: Ndërlidhja e programeve shkollore me nevojat e tregut të punës**

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1:Rritja e bashkëpunimit Shkollë profesionale – me tregun e punës.	Fuqizimi i punës së qendrës karrierës dhe këshillimit për orientim në karrierë Java e dyerve të hapura .	Rritja e numrit të nxënësve të interesuar për profilet e shkollës profesionale.
Rezultati 2:Realizimi i praktikës profesionale në ndërmarrje.	. -Realizimi i internshipit si hap drejt punësimit -Sigurimi i ndërmarrjeve për realizimin e praktikës profesionale. -Krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet që sigurojnë realizimin e praktikës profesionale.	Informata kthyesë nga bizneset dhe certifikimi.
Rezultati 3: Rritja e numrit të nxënësve që punësohen.	-Harmonizimi i plan programeve dhe profileve me tregun e punës. -Lidhja e marrëveshjeve me ndërmarrjet për punësimin e nxënësve; -Krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet që sigurojnë punësimin e nxënësve.	Përmes evidentimit të nxënësve që punësohen.

**Prioriteti 3: Gjithë përfshirja në arsim**

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Përfshirja e shtuar e fëmijëve në edukimin parashkollor.	1.1.Analizimi i mundësisë buxhetore që të paktën për çdo vit të punësohet një edukatore bazuar në UA.Nr.19/16 . 1.2. Varësisht nga numri i fëmijëve caktohet edhe numri edukatoreve në shkolla.	1.1.Raportet statistikore. 1.2. Numri i shtuar i fëmijëve. 1.2. Rritja e numrit të punëtorëve në arsim.
Rezultati 2: Përfshirja e gjithë nxënësve në arsimin e obliguar me mundësi të barabarta.	2.1.Ekipi për EPRBM ( i cili është funksional në DKA-Vushtrri, si dhe ekipi i shkollës) vazhdimisht përcjell gjendjen e braktisjes në shkolla.	2.1. Raportet nga drejtorët e shkollave si hapi i parë i informimit. 2.1.Statistika në EMIS ( sistemi i të dhënave statistikore). 2.2. Dosja e dëshmuar për braktisje.
Rezultati 3: Fëmijët me nevoja të veçanta janë përfshirë në sistemin arsimor para universitar.	3.1. Ekipi PIA ( është funksional në DKA-Vushtrri) 3.2. Vazhdimisht vlerësojnë fëmijët më nevoja të veçanta arsimore bazuar në UA.Nr.07/2012 . 3.3. Identifikimi i fëmijëve më nevoja të veçanta . 3.4. Integrimi i fëmijëve më nevoja të veçanta në klasa të rregullta. 3.5.Sigurimi i transportit për fëmijë me nevoja të veçanta 3.6.Mësimdhënëset mbështetëse ofrojnë përkrahje për mësimdhënës që punojnë më fëmijë me nevoja të veçanta.	3.1,2,3.Dosja e vlerësimit . 3.3,4. Raportet statistikore . 3.5. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore të planifikuara për transport . 3.6. Raporte nga psikologu dhe shërbimet e nevojshme përkrahëse për fëmijë me nevoja të veçanta.



<p>Rezultati 4: Integrimi i nxënësve të komunitetit pakicë.</p>	<p>4.1. Identifikimi i fëmijëve të komunitetit pakicë. 4.2. Lehtësimi i regjistrimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet arsimore.</p>	<p>4.1. Raportet statistikore. 4.2. Statistika në EMIS ( sistemi i të dhënave statistikore )</p>
<p>Rezultati 5. Integrimi i nxënësve të riatdhesuar.</p>	<p>5.1. Sistemi i nxënësve në klasa sipas UA.Nr.19/201.5</p>	<p>5.1. Raportet statistikore. 5.1. Statistika në EMIS ( sistemi i të dhënave statistikore. 5.1. Proceverbale të ditare të klasave.</p>

Prioriteti 4: Ambiente të përshtatshme shkollore

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
<p>Rezultati 1: Infrastruktura shkollore bashkëkohore.</p>	<p>1.1.Ndërtimi i Shkollave të reja: SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar, SHFMU "Gj.K.Skënderbeu" Pantinë, si dhe ndërtimi i SHFMU "Bajram Curri" në Dumnicë ( projekt dy vjeçar).</p> <p>1.2.Renovimi i Shkollave: Meremetimi i SHF "Naim Frashëri" Vushtrri, rehabilitimi i kulmit në SHMU-2, meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa" Ceceli, ndërrimi i dyerve dhe dritareve në SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri, ndërrimi i dyerve dhe dritareve ne SHFMU "Migjeni" Lagjja Cakaj, ndërrimi i dyerve ne SHFMU-Reznik, ndërrimi i dyerve ne SHFMU "Azem Bejta" Beqiq (paralelja e ndarë) , instalimi i ujës-jellësit dhe kanalizimit ne SHMU-1.</p> <p>1.3 Ndërtimi i Fushave sportive: Ndërtimi i fushës sportive në Pestovë.</p> <p>1.4.Rehabilitimi i fushës sportive në SHFMU "Liria" Stroc, Rehabilitimi i fushës sportive edhe platos në SHFMU "Emin Duraku" Novolan.</p> <p>1.5. Ndërtimi i rrethojës ne SHFMU-Lagjja Cakaj, ndërtimi i rrethojës në SHF "Ali Kelmendi" Vushtrri.</p>	<p>1.1. Shkolla të reja të ndërtuara.</p> <p>1.2.Shkolla të rinovuara.</p> <p>1.1.2.3. Efiçienca e zvogëluar.</p> <p>1.3.Fusha sportive.</p> <p>1.4.Salla sportive.</p> <p>1.5.Siguria në shkolla</p>

<p>Rezultati 2: Teknologjia bashkëkohore.</p>	<p>2.1. Pajisja e kabineteve më kompjuterë. 2.2. Rrjeti i internetit në të gjitha shkollat. 2.3. Funksionimi i mësimi elektronik. 2.4. Përgatitja për funksionimin E. Matura. 2.5. Pajisja me video projektorë.</p>	<p>2.1,5. Dosja e inventarizimit në nivel shkollave. 2.1. Dosja e inventarizimit në nivel DKA-së. 2.2. Pasqyra e shkollave më internet. 2.3. Gjenerimi i të dhënave në i mësimi elektronik. 2.4. Pilotimi i shkollave për E .Matura.</p>
<p>Rezultati 3: Kabinetet shkencore në funksion të mësimi praktik.</p>	<p>3.1. Identifikimi i nevojave për kabinete . 3.2. Shfrytëzimi i donacioneve. 3.3. Inkurajomë shkollat që nga buxheti i shkollës të planifikojë mjete për kabinete shkollore. 3.4. Inkurajojmë shkollat për aplikim në granate të bankës botërore.</p>	<p>3.1. Shqyrtimi i nevojave për kabinete . 3.2. Pajisja më kabinete. 3.3. Prezantimi i punime nga fusha e shkencave në panairë shkencore ( e që në Vushtrri mbahet çdo vit) . 3.4. Bazuar në përfitimin e projektit.</p>

Prioriteti 5: MENAXHIMI I SISTEMIT ARSIMOR

Rezultatet :	Çfarë veprimi do të ndërmerrni për të arritur ato rezultate?	Si do të dini nëse e keni arritur rezultatin?
Rezultati 1: Ndërtohen kapacitete për menaxhim efektiv dhe të përgjegjshëm të sistemit në nivelin komunal.	<p>1.1.Trajnimi i personelit të DKA-ve sipas nevojave të identifikuara.</p> <p>1.1. Zbatimi i të gjitha ligjeve, udhëzimeve administrative, dhe rregulloreve për arsim.</p> <p>1.2. Fuqizimi i qasjes së integruar në planifikim midis MASHT – DKA – Shkollë.</p> <p>1.3. Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe të komunikimit në mes të shkollave në fushën e udhëheqjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve.</p> <p>1.4.Menaxhimi i rrjetit të shkollave.</p> <p>1.5.Fuqizimi i autonomisë së shkollës.</p>	<p>1.1.Dosja e zyrtarëve</p> <p>1.1.Certifikimi</p> <p>1.2,3,4,5.Vlerësimi vjetor i zyrtareve të DKA-së , raportet.</p>
Rezultati 2: Përcaktimi i standardeve profesionale për mekanizmin e punësimit dhe menaxhimit të karrierës së udhëheqësve të institucioneve edukative-arsimore	<p>2.1. Përcaktimi i statusit të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve edukative arsimore.</p> <p>2.2. Krijimi i mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të performancës së drejtorëve dhe zëvendës-drejtorëve.</p> <p>2.3. Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të karrierës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në bazë të standardeve të aplikueshme</p>	<p>2.1. Procedurat e procesit të vlerësimi të drejtorëve</p> <p>2.2. Raporte e monitoruese</p> <p>2.2,3. Dosjet,</p> <p>2.3. Certifikatat për udhëheqje arsimore</p>
Rezultati 3: Përgatiten dhe publikohen raporte të rregullta të bazuara në analiza dhe interpretim të dhënave nga SMIA, si dhe shfrytëzohen këto analiza në politikë bërje	<p>3.1. Ristrukturimi i divizionit për koordinim të politikave dhe statistika që të qartësohen rolet që lidhen me SMIA</p> <p>3.2.Zhvillimi i kapaciteteve për mbledhje, analizë dhe interpretim të avancuar të dhënave.</p> <p>3.3. Zhvillim i procedurave për menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre</p>	<p>3.1.Gjenerimi i të dhënave.</p> <p>3.2. Rraporet vjetore.</p> <p>3.3. Raporte të gjysmë vjetorëve shkollore.</p>

**PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT – PLANI I BURIMEVE**

Prioritetit 1: Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë				
	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	
Rezultati 2.	1000	1500	1500	
Rezultati 3.	P kosto	Pa kosto	Pa kosto	
Rezultati 4.	2500	3000	4000	
Rezultati 5.	500	500	500	

Prioritetit 2:				
	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Koston e planifikon shkolla
Rezultati 2.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Koston e planifikon shkolla
Rezultati 3.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Koston e planifikon shkolla

Prioritetit 3: Gjithë përfshirja në arsim				
	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1	4536	4536	4536	
Rezultati 2.	100	200	200	Këtu hyn transporti për terren
Rezultati 3.	100	200	200	Këtu hyn transporti për terren
Rezultati 4.	100	100	100	Këtu hyn transporti për terren
Rezultati 5.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	

Prioritetit 4: Ambiente të përshtatshme shkollore				
	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1	212,000.00	150,000.00	100,000.00	
Rezultati 2.	14,500.00	14,500.00	14,500.00	
Rezultati 3.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	

Prioritetit 5: Menaxhimi i sistemit arsimor				
	Shpenzimet për vitin e parë në €	Shpenzimet për vitin e dytë në €	Shpenzimet për vitin e tretë në €	Vërejtje:
Rezultati 1	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	MASHT i kryen këto obligime
Rezultati 2.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Në bashkëpunim me MASHT
Rezultati 3.	Pa kosto	Pa kosto	Pa kosto	Në bashkëpunim me MASHT

## PËRMBLEDHJA E PRIORITETVE TË SHKOLLAVE

Shkollat	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti	Prioriteti
''Abdyl Frashëri'' Druar	Profesionalizmi i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja e shkollës më TIK	Revista e shkollës, Garat komunale, republikane	
''Adem Voca'' Pasomë	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Rregullimi i terrenit sportiv	Pajisja e shkollës më video projektor	Garat e brendshme te diturisë	
''Ali Kelmendi'' Vushtrri	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Kultura e mësim nxënies cilësia e mësimdhënies dhe procesi i mësimi	Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës	Zhvillimi profesional i personelit mësimor rezultatet dhe suksesit	Fokusi dhe strategjia e zhvillimit të cilësisë , gjithëpërfshirës
''Azem Bejta'' Dubofç	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Ndërtimi i fushave sportive		
''A.Z.Çajupi'' Vushtrri	Bashkëpunimi i mirë dhe i rregullt më shkolla tjera dhe komunitetin	Bashkëpunimi i mirë në mes të nxënësve	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Arritjet e nxënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë
''Bajram Curri '' Dumnicë e Mesme	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Bashkëpunimi më prindër	Mësimdhënia e integruar	Ngritja profesionale e mësimdhënësve	Motivimi i nxënësve



'' Emin Duraku''	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Ndërtimi i poligonit sportiv		
''Enver Hadri'' Smrekonicë	Krijimi i kushteve në infrastrukturë	Trajnimet e vazhdueshme të mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë		
'Gj.K.Skenderbeu' Pantinë	Rregullimi i infrastrukturës në shkollë	Funksionalizimi i gjithëpërfshirjes	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Rritja performancës së nxënësve	
''Jusuf Gërvalla'' Dumnicë e Poshtme	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja e bibliotekës		
'' Liria'' Strofc	Menaxhimi i objektit Shkollor të brendshëm dhe të jashtëm	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja e shkollës më TIK	Profesionalizimi i mësimdhënësve	Revista e shkollës, Garat komunale, republikane
''Lumni Surdulli'' Samadrexhë	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Rritja e performancës së mësimdhënësve	Zhvillimi metodave të vlerësimit dhe instrumenteve monitoruese		
''Migjeni'' Stanofc i Epërm	Infrastruktura shkollore	Trajnimi i mësimdhënësve	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Kultura e shkollës
''Mustafë Shyti'' Oshlan	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Informimi i prindërve dhe nxënësve më risët që ofron KK	Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies	Pasqyrimi i aktiviteteve të nxënësve në faqe e shkollës	

'Mustafë Venhari ' Vushtrri	Shkolla të sigurojë cilësi duke bashkëvepruar me KC	Përgatitja dhe avancimi i mësimit për hartimin e planeve	Përgatitja e mësimit për zbatimin e KK	Përgatitja e mësimit për hartimin e planeve vjetor	Progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve
''Naim Frashëri'' Vushtrri	Rregullimi i infrastrukturës në shkollë	Zbatimi i punës ekipore	Funksionalizmi i gjithëpërfshirës në shkollë	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	
'Nazmi Zhegrova' Stanofc i P.	Përmirësimi i kushteve në shkollë	Trajnimet e mësimit	Siguria e cilësisë në mësimit		
'Rexhep Musa'' Ceceli	Ngritja e cilësisë së mësimit dhe nxënësve	Bashkëpunimi në procesin e të nxënësve	Mësimi i integruar	Trajnimi i mësimit	Bashkëpunimi
'' Rilindja'' Maxhunaj	Infrastruktura e brendshme e shkollës	Trajnimet e mësimit	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë		
'Rrustem Hyseni Skromë	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Zhvillimi profesional i mësimit	Vlerësimi i brendshëm i shkollës		
' 28 Nëntori'' Vërrnicë	Profesionalizmi i mësimit	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Menaxhimi i objektit shkollor	Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës	Gjithë përfshirja
'Bahri Kuqi'' Shtruerë	Profesionalizmi i mësimit	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Ambienti i shkollës	Pajisja e bibliotekës	Pajisja e shkollës me projektor
SHMU-1	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Bashkëpunimi në procesin e të nxënësve	Mësimi i integruar	Ngritja profesionale e mësimit	

“Latif Berisha” Dobërllukë	Infrastruktura e brendshme e shkollës	Trajnimet e mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë		
Nedakoc	Menaxhimi i objektit shkollor	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja me IT.	Zhvillimi profesional për KK dhe metodologjinë bashkëkohore	Buletini informativ , garat e diturisë
Mihaliq	Mësimdhënie cilësore dhe nxënie efektive	Klimë miqësore për nxënësit	Trajnimi për TIK	Transparenca dhe llogaridhënia	Zhvillimi profesional
Lumadh	Trajnimi i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Shkëmbimi i përvojave më shkollat tjera		
Reznik	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja me IT.	Buletini informativ	
Akrashticë	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Fuqizimi i KDSH-së	Trajnimet për KKK	Investimi në TIK	Krijimi i një ambienti të mirë shkollor
SHMU-2	Fuqizimi i KDSH-së	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Botimi i buletinit informativ	Trajnimi i mësimdhënësve për KKK	
Bukosh	Profesionalizmi i mësimdhënësve	Ambienti i mirë shkollor	Pajisja e bibliotekës	Pajisja e shkollës më Projektor	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë
SHFMU’’Dëshmorë’’	Ambienti shkollor	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Pajisja me IT	Zhvillimi i profesional i mësimdhënësve	

Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	Menaxhimi dhe qeverisja	Zbatimi i IT	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	Mësim nxënia dhe mësimdhënia	Mësimi i integruar
SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri	Trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin e KK	Trajnimi i mësimdhënësve për realizimin e kompetencave	Ambient i përshtatshëm		
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	Ndërlidhja e programeve shkollore me nevojat e tregut të punës	Kultura dhe mjedisi shkollor	Mësimnxënia dhe nxënia	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Performanca e nxënësve
Çerdhja "Foleja" Vushtrri	Menaxhimi i objektit shkollor të brendshëm dhe të jashtëm	Kultura, mësimi, cilësia e mësimdhënies dhe procesi i mësimi, bashkëpunimi me prindër dhe me komunitet	Pajisja e shkollës me mjete didaktike metodike dhe më lodra të ndryshme funksionale	Sigurimi dhe zhvillimi i cilësisë	

Prioritete të tjera të arsimit në komunë:

Bashkëpunimi cilësor dhe efikas në mes organizatave dhe donatorëve

Mësimi gjatë gjithë jetës

Shkolla që punojnë në një ndërrim

Rritja e efijencës

Forcimi i kapaciteteve menaxhuese te shkollave

Ndërtimi i çerdhes së dytë në qetet

## RAPORTI MBI PLANIN E VITIT PARAPRAK

### ZHVILLIMI I ARSIMIT NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Është viti i tretë ku pilotohet KKK në tri shkollat e Komunës së Vushtrrisë.

Janë monitoruar të gjitha shkollat për menaxhim dhe mbarëvajtje të procesit mësimor.

Janë vlerësuar të gjithë fëmijët më nevoja të veçanta.

Janë trajnuar të gjithë mësime dhënësit për PIA që punojnë me nxënës më nevoja të veçanta.

Janë zgjedhur koordinatorët e cilësisë në nivel shkolle.

### PROJEKTET E REALIZUARA NË 2016

- Ndërtimi i shkollave në Druar, Pantinë (janë projekte dy vjeçare , të gjitha në vlerë prej 867,758.000 euro).
- U përfundua renovimi i SHF "Naim Frashëri" Vushtrri,- Ndërrimi i kulmit në vlerë prej 19,970.99 euro.
- Janë ndërtuar fusha sportive (dy ndërtim dhe një rehabilitim) në: SHFMU „Enver Hadri” në Smrekonicë (rehabilitim), SHFMU „Andon Zako Çajupi” në Vushtrri dhe SHFMU-Lumadh më vlerë 45.107,34 euro.
- Furnizimi , demotimi dhe montimi i kaldasë në Gjimnazin ”E.Çabej” ,më vlerë 8,740.00 Euro.
- U renovuan dritaret në SHMP”Bahri Kuqi”Shtruerë më vlerë 4,610.00 euro.
- Furnizimi me inventar për shkolla në shumë 3,762.00 euro.
- U renovua SHFMU”Mihaliq në vlerë 3,584,28 euro.
- Rregullimi i nyjeve sanitare në SHFMU”Enver Hadri”Smrekonicë në vlerë 4,240.50 euro.
- Renovimi i dritarëve në Beqiq në vlerë 2,890.00 euro.
- U përfundua kulmi i çerdhës ”Foleja” Vushtrri.
- Furnizim më pajisje laboratorike për kabinet të fizikës në SHMU-1 2,997.00 Euro.
- Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me 7 (shtatë) kompani, ku 22 nxënës të shkollave të mesme dhe të larta profesionale „Bahri Haxha” dhe asaj teknike „Lutfi Musiqi” e zhvillojnë praktikën profesionale.

- Janë mbuluar shpenzimet e transportit për nxënësit (fëmijë) me nevoja të veçanta, si dhe për fëmijët me kushte të rënda ekonomike.
- Në muajin mars janë ndarë bursa për 32 studentë në shumë prej 12,800.00 euro. Në muajin dhjetor ju është vazhduar bursa 28 studentë më automatizëm.
- Më datë 11.11.2016 në muajin nëntor u përrua shkolla në SHFMU''Rilindja'' Maxhunaj.

## **DONACIONET E REALIZUARA NË 2016**

- Është në renovim të tërësishëm SHMP „Bahri Haxha’’Vushtrri me vlerë 437,917.85 euro financuar nga ushtria e SHBA-së.
- Është renovuar SHFMU''Emin Duraku'' Novolan me vlerë më shumë 20,000 euro nga vëllezërit Kovaqi.
- Organizata KEC-,MASHT furnizoi SHMU-2 me pajisje të TIK me vlerë 6,000.00 Euro dhe 20,000.00 euro projekti i BE-së.
- Në muajin gusht u shpërndanë të gjitha shkollave fillore dhe të mesme të ulëta pakot nga donacioni përfitues të grantit nga USAID përmes fhi360-BEP, për mesimdhënësit të cilët kanë kryer me sukses kursin e matematikes dhe kursin e leximit me Basic Education Program të USAID-it. Vlera e gjithmbarshme e donacionit për Komunën e Vushtrrisë është 8.772,80€. Në pako përfshihen mjete ndihmëse për mesimdhënësit.
- Në muajin tetor u finalizua projekti nga organizata ''BOSPORUS'' ku studentët turq që jetojnë në Holandë e renovuan objektin shkollor në lagjen Cakaj me vlerë 21,500.00.Euro.
- Në muajin tetor u finalizua projekti në Gjimnazin ''E.Çabej''Vushtrri ku u përrua plotësimi i mjeteve sportive në sallën sportive në gjimnaz, ku organizata TIKA- financoi më donacion 12.800 Euro.
- Në muajin tetor u finalizua projekti në Çerdhen ''Foleja'' organizata TIKA financoi më donacion për afër 13,000.00 euro.
- Në muajin dhejtor Shoqata ''HAI''Vushtrri ka jep donacion tepision (llastiku) për krejt shkollën e SHFMU''Bajram Curri''Dumicë e M. si dhe në SHFMU-Nedakoc një klasë , dhe krejt klasat në Beqiq paralelen e ndarë në SHFMU''Azem Bejta''Dubofc.

- Në muajin nëntor organizata e CARITAS zvicrran më përfaqësim në Kosovë , dha donacion për 5 klasë të parashkollorëve më vlerë 3000 euro për secilën klasë pra gjithësej 15.000 euro. Nga një klasë të përfshira janë: çerdhja’’ Foleja’’Vushtrri, SHFMU’’Rilindja’’ Maxhunaj, paralelja në Pestovë, SHFMU’’Lumni Surdulli’’ Samadrexhë, SHFMU- Akrashticë .

### **Rezultatet e shkollave në gara të diturisë dhe sportive**

- Arbër Igrishta, nx. i kl. XII në Gjimnazin Eqrem Çabej’’ – vendi i tretë në nivel Republikan në garën e Olimpiadës Matematike të Kosovës.
- Nxënësit e SHMU-II-, vendi i parë, në kuizin e organizuar në nivel Republikan nga Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, në bashkëpunim me MASHT-in.
- Nxënësit e SHMU-I- vendi i parë në kuizin e „ CHAMPION QUIZ’’ , të organizuar në nivel Republikan nga Klan Kosova.
- Adrian Krasniqi nxënës në SHMU-II- , zuri vendin e dytë në Kimi, në garën e organizuar nga kolegji „Mehmet Akif’’ , në nivel Republikan.
- Në muajin nëntor në garat e kimisë të organizuara nga Kolegji ‘’Mehmet Akif’’ Banullë , garuan 900 nxënës nga gjithë Kosova , vendin e dytë në nivel Kosove e zuri Arlind Shefkiu nxënës i SHFMU’’ Abdyl Frashëri’’ Druar.
- U mbajt aktivitetin sportiv në futboll dhe volejboll që u organizua nga Projekti i Këshillit të Evropës në Prishtinë e nën patronatin e kryetarit të Komunës, z. Bajram Mulaku. Aktiviteti u zhvillua me dt. 28 dhe 29.09.2016 në palestrën e sportit „Jeton Tërrstena –Tota’’.
- U mbajt gara e diturisë e organizuar nga shoqata ‘’HAI’’ Vushtrri në bashkëpunim më DKA-në, gara u zhvillua në mes të shkollave: SHFMU-Nedakoc, SHFMU’’Enver Hadri’’ Smrekonicë, SHFMU’’A.Z.Çajupi’’ Vushtrri, SHFMU’’Bahri Kuqi’’ Shtruerë, SHFMU’’Abdyl Frashëri’’ Druar si dhe shoqata ‘’HAI’’ në Vushtrri. Vendin e parë e zuri SHMFU-Nedakoc, ndërsa u shpërblye nga kjo shoqatë për tre nxënës nga një IPAD më vlerë 70 euro ndërsa shkollës 700 euro . Më datë 17 .11.2016 u mbajtën garat në volejboll femrat në mes të këtyre shkollave , vendin e parë e zuri shkolla SHFMU’’Bahri Kuqi’’ Shtruerë , ku mori edhe kupën dhe secili nxënës nga një medale për vendin e parë , dytë dhe të tretë. Ndërsa shkolla fituese, fitoi kupën, medalen për secilin nxënës dhe dresat dhe 200 euro për mjete sportive.



- Volejbol, SHMT, „Lutfi Musiqi” Vushtrri, Vendi i parë (meshkujt) në nivel Republikan.
- Volejbol, SHFMU, „Emin Duraku” Novolan, Vendi i parë (meshkujt) në nivel Republikan
- Pingpong- SHMU-II- , Vushtrri, Vendi i parë (meshkujt) në nivel Republikan.
- Pingpong- SHMU-II- , Vushtrri, Vendi i parë (Femrat) në nivel Republikan.
- 

## **TRAJNIMET**

Qendra për ngritje profesionale në Vushtrri ishte në funksion të shërbimit të trajnimeve të ndryshme të mbajtura edhe gjatë kësaj periudhe:

U trajnuan 50 mësime për Vlerësimin Formativ (vlerësimi bashkëkohor) nga BEP.

U trajnuan 24 anëtarë të këshillit drejtues të shkollave nga BEP.

U trajnuan 52 arsimtarë për hulumtim në veprim nga Instituti Pedagogjik i Kosovës.

U trajnuan 25 nxënës të këshillit të nxënësve nga BEP.

U trajnuan 14 mësime për menaxhim dhe udhëheqje nga GIZ.